



Pranuar / Dorezuar Priljenol/Podato Received/Delivery	31-07-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedimica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtj. e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMB/KC	5455	/2023	117



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.891/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.891/2023 të datës 29.06.2023 e plotësuar më datën 05.07.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit me numër 08Nr.01-101/03-56473 të datës 16.06.2023 të Udhëheqësit të Drejtpërdrejtë dhe Vendimit me numër 01 Nr.118/02-30756 të datës 27.06.2023 të Kryetarit të Komunës së Drenasit, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 31.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.819/2023 e datës 29.06.2023 e plotësuar më datë 05.07.2023 e parashtruar nga ankuesja

II. Shfuqizohet Vendimi me numër 08Nr.01-101/03-56473 i datës 16.06.2023 i Udhëheqësit të Drejtpërdrejtë të ankueses për moskonfirmim të marrëdhënies së punës dhe Vendimi me numër 01 Nr.118/02-30756 i datës 27.06.2023 i Kryetarit të Komunës së Drenasit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ankueses.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Drenasit dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesen në vendin e punës Zyrtar për Leje Ndërtimore sipas Akt Emërimit AE.Nr.01-101/03-56473 të datës 13.01.2022 më të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga

marrëdhënia e punës, duke bërë kompensimin e pagës nga dita e mos konfirmimit të marrëdhënies së punës.

IV. Ky vendim zëvendëson formularin e vlerësimit të periudhës provues për ankuesen.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja në bazë të Akt Emërimit AE.Nr.01-101/03-56473 të datës 13.01.2022, ka themeluar marrëdhënie pune në Komunën e Drenasit në pozitën *Zyrtare për Leje Ndërtimore*, ku periudha provuese ka qenë një vjeçare nga fillimi i marrëdhënies së punës, mirëpo përmes shkresës së datës 16.12.2022 të dërguar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses për Shefen e Personelit duke njoftuar se periudha provuese për ankuesen vazhdohet për gjatë (6) muaj, për shkak që nuk kemi pasur mundësi të bëjmë vlerësimin e saktë për zyrtaren. Ankuesja më datë 20.02.2023 ka kërkuar që të bëhet vlerësimi i periudhës provuese sepse nuk ka marr një vlerësim.

Më datë 16.06.2023 mentorja e caktuar për mbikëqyrjen e punës së ankueses ka dhënë rekomandim për mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të ankueses, që ankueses mos t'i konfirmohet periudha provuese sepse ka pasur masë disiplinore vërejtje me gojë dhe ka pasur mos respektim të afateve për vendimmarrje për lëndët të cilat janë caktuar.

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses më datë 16.06.2023 ka nxjerr Vendim me numër 08Nr.01-101/03-56473 përmes të cilit ankueses nuk i është konfirmuar vazhdimi i marrëdhënies së punës me arsyetimin se për shkak të vërejtjeve me shkrim dhe duke marr parasysh rekomandimin me shkrim të mentores.

Kryetari i Komunës së Drenasit më datë 27.06.2023 ka nxjerr Vendim me numër 01 Nr.118/02-30756, përmes të cilit ankuese i ndërpritet marrëdhënia e punës.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër 08Nr.01-101/03-56473 të datës 16.06.2023 të Udhëheqësit të Drejtpërdrejtë të ankueses për moskonfirmim të marrëdhënies së punës, më datë 29.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4953/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa meqë lënda është vazhdimësi, ankuesja, më datë 05.07.2023 ka bërë plotësimin e ankueses duke kundërshtuar Vendimin me numër 01 Nr.118/02-30756 të datës 27.06.2023 të Kryetarit të Komunës së Drenasit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Drenasit. Ndërsa Këshilli më datë 07.07.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me provat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 4953/2023 e datës 29.06.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 08Nr.01-101/03-56473 të datës 16.06.2023 të Udhëheqësit të Drejtpërdrejtë të ankueses për moskonfirmim të marrëdhënies së punës; Kërkesën e datës 21.06.2023 nga ankuesja për Drejtorin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Zyrën e Personelit; Emailin e datës 06.12.2022 nga H.H për Sh.D; Emailin e datës 20.02.2023 nga ankuesja për Sh.D; Akt Emërimit AE.Nr.01-101/03-56473 të datës 13.01.2022; Rezultatet e vlerësimit për grupin Specialit i Arkitekturës datës 30.12.2021; Konkursin e datës 04.11.2021 për grupin Specialit të Arkitekturës; Plotësimin e ankesës e datës 05.07.2023 me numër protokoll 891/2023 nga ankuesja; Vendimin me numër 01 Nr.118/02-30756 të datës 27.06.2023 të Kryetarit të Komunës së Drenasit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 30.06.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 07.07.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar për Leje Ndërtimore i datës 13.01.2022; Njoftimin e datës 21.02.2023 nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë për Zyrën e Personelit; Emailin e datës 24.10.2022 nga F.A për Sh.D; Emailin e datës 24.10.2022 nga Sh.D për H.H; Shkresën e datës 16.12.2022 nga Shefi i Sektorit për Planifikim për Shefen e Personelit; Informimin e datës 16.12.2022 nga Sh.D për Drejtorin e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit; Rekomandim i datës 16.06.2023; Informimin lidhur me mos konfirmimin e vazhdimin të kontratës i datës 16.06.2023; Vendimin e datës 16.12.202 për zgjatjen e punës provuese; Certifikatën për pjesëmarrje në trajnim për ankueses prill 2022; Raportin javor 16-20.05.2022; Raportin javor 30.05-30.06.2022; Vendimin me numër 08Nr.351/01-36419 e datës 11.11.2022; Aplikacionin për leje ndërtimore i datës 25.04.2023; Informatë nga Sh.D për F.A; Njoftim përmes emailit i datës 16.06.2023 nga F.K për Sh.D.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e bazuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 29.06.2023 dhe të plotësuar më datë 05.07.2023, ndaj Vendimit me numër 08Nr.01-101/03-56473 të datës 16.06.2023 të Udhëheqësit të Drejtpërdrejtë për moskonfirmim të marrëdhënies së punës dhe Vendimit me numër 01 Nr.118/02-30756 të datës 27.06.2023 të Kryetarit të Komunës së Drenasit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, pretendon se i tërë ky proces është përcjellë me shkelje procedurale dhe materiale, ngase: Asnjëherë për punën time nuk kam pasur dhe nuk kam pranuar vërejtje kështu që zgjatja e afatit për gjashtë muaj për vlerësim me arsyetimin se ndaj meje ka pasur vërejtje është e paqëndrueshme; Nuk kam pranuar asnjë formular të vlerësimit të periudhës provuese dhe nuk është mbajtur asnjë takim me mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë; Nuk kam pasur asnjë njoftim për zgjatjen e periudhës së vlerësimit dhe kjo është bërë vetëm kur unë kam reaguar sipas emailit të datës 20.02.2023; Kështu që vendimet e kontestuar me këtë ankesë janë në kundërshtim me legjislacionin për zyrtarët publikë dhe Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në kuadër të provave të lëndës, thekson faktin se ankuesja në kohën kur ka themeluar marrëdhënie punë në pozitë e lartçekura, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë më datë 21.02.2022 ka caktuar znj. F.K mentorë të ankueses ashtu

siç e kërkon procedura ligjore e paraparë me nenin 37 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrтарët Publikë dhe nenin 34 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si rrjedhojë më datë 16.12.2022 mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses ka informuar Shefen e Personelit se lidhur me vlerësimin e periudhës provuese për ankuesen zgjatet afati për gjatë (6) muaj për shkak që nuk kemi pasur mundësi të bëjmë vlerësimin e saktë për zyrtaren ngase është aplikuar masa disiplinore ndaj zyrtares.

Ndërlidhur me këtë Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses se asnjëherë për punën time nuk kam pas dhe nuk kam pranuar vërejtje kështu që zgjatja e afatit për gjashtë muaj për vlerësim me arsyetimin se ndaj meje ka pasur vërejtje është e paqëndrueshme, dhe në bazë të provave të lëndës, konstaton se më datë 24.10.2022 mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ka njoftuar Udhëheqësen e Njësies së Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit se *“përmes këtij emaili ju njoftoj për shqiptimin e masës disiplinor Paralajmërim verbal për Zyrtaren për Leje Ndërtimore E.T në pajtim me nenin 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil”*. Rrjedhimisht mbi bazën e provave të lëndës, nuk ka asnjë dëshmi që ky email lidhur me këtë masë t’i jetë dërguar ankueses apo të jetë njoftuar ankuesja, si rezultat i kësaj është vepruar në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“1. Organet publike duhet të veprojnë me transparencë. 2. Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t’u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj”* dhe nenin 24 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrтарët Publikë, i cili përcakton se: *“1. Zyrtari publik ka të drejtën të informohet për fillimin e çdo procedure dhe çdo vendimmarrje, që ka të bëjë me marrëdhënien e tij të punës”*. Për me tepër kjo masë kinse është shqiptuar ndaj ankueses nuk ka as mbështetje ligjore për shkak që e njëjta është shqiptuar mbi bazën e Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil e cila nuk është në fuqi nga viti 2020 ngase e njëjta është e shfuqizuar sipas nenit 20 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Sa i përket zgjatjes së afatit prej gjashtë (6) muaj për vlerësimin e periudhës së provës, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas nenit 37 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrтарët Publikë si dhe nenit 38 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“6.Nëse, për shkaqe të justifikuara, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 32 të kësaj rregullore, nuk ka qenë e mundur kryerja e plotë e vlerësimit të nëpunësit në periudhë provuese, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë mund të vendosë, zgjatjen e periudhës së provës, për një përudhë deri në gjashtë (6) muaj”*, si rrjedhojë kushti për zgjatjen e këtij afati duhet të ndërlidhet me nenin 32 paragrafi 3 të kësaj rregulloreje i cili ka përcaktuar qëllimet e periudhës provuese, duke përcaktuar se: *“3. Puna provuese pezullohet në rast dhe për kohëzgjatjen aktuale të pushimit të lehonisë, pushimit të atësisë, pushimit prindëror pushimit mjekësor, shërbimit ushtarak, fushatës zgjedhore dhe/apo rrethanave të tjera të veçanta. Pas përfundimit të shkakut të ndërprerjes, periudha e provës zgjatet për kohën sa është bërë ndërprerja”*, si rezultat i kësaj nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet e lartcekura apo ndonjë kusht tjetër i arsyetuar dhe konkret. Për me tepër ankuesja në bazë të provave të lëndës nuk ka qenë e njoftuar për zgjatjen e këtij afati dhe kjo ka bërë që ankuesja më datë 20.02.2023 ka kërkuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt Sh.D se më datë 17.01.2023 ka përfunduar një vit i punës në këtë pozitë dhe

pavarësisht kësaj nuk ka marr vlerësimin e periudhës duke kërkuar edhe arsyt pse kjo çështje është vonuar, mirëpo sipas provave të lëndës edhe në këtë rast ankuesja nuk ka marr ndonjë përgjigje nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i saj, mbi këtë bazë janë shkelur parimet e përcaktuara me nenin 9 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 24 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ngase në këtë rast janë cenuar parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë të përcaktuara me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"1. Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë"*, kështu që mbi konstatimet si më lartë pretendimi i ankueses është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se nuk kam pranuar asnjë formular të vlerësimit të periudhës provuese dhe nuk është mbajtur asnjë takim me mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas nenit 36 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *"1. Nëpunësi civil, gjatë periudhës provuese, i nënshtrohet vlerësimit të posaçëm të rezultateve në punë. 2. Kriteret që përcaktojnë vlerësimin e punës së tij/saj provuese, janë: 2.1. realizimi i kënaqshëm i detyrave të punës; 2.2. gatishmëria, kreativiteti dhe vetë- iniciativa për kryerjen e detyrave të punës; 2.3. respektimi i rregullave të mirësjelljes në Shërbimin Civil; 2.4. respektimi i orarit të punës"*, si rrjedhojë mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses me këtë rast nuk ka përdorur formularin e vlerësimit të periudhës provuese i cili mbështetet në kriteret e përcaktuara me dispozitën e lartcekur, mirëpo mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses mos konfirmimin e periudhës provuese e ka bërë vetëm mbi bazë të Vendimit me numër 08Nr.01-101/03-56473 i datës 16.06.2023, duke mos respektuar dispozitat e nenit 37 paragrafi 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"4. Takimi për vlerësimin e periudhës provuese organizohet me qëllim që udhëheqësi i drejtpërdrejtë dhe nëpunësi civil të bashkëbisedojnë për përmbushjen e detyrave të punës gjatë periudhës provuese. 5. Gjatë takimit, mendimi dhe vërejtjet e nëpunësit civil për realizimin e detyrave të punës së tij merren në konsideratë"*.

Po ashtu sipas kërkesës për përgjigje në ankesë të datës 30.06.2023 kemi kërkuar nga Komuna e Drenasit të dërgoj *"dëshmi për takime apo vlerësim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë gjatë tërë punës provuese dhe dëshmi për informim për të arriturat dhe ngecjet në kryerjen e detyrave të punës"*, mirëpo në bazë të përgjigjes në ankesë që kemi pranuar nuk është ofruar asnjë provë relevante me të cilën do të dëshmohej se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses gjatë periudhës vlerësuese të ketë ofruar gatishmërinë që të njoftoj ankuesen nëse gjatë kësaj periudhe cilat kanë qenë të arriturat apo ngecjes, si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses nuk ka respektuar nenin 36 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"3. Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë vlerëson nëpunësin civil gjatë tërë punës provuese dhe e informon për të arriturat dhe ngecjet në kryerjen e detyrave të punës"*, ngase caktimi i një mentori nuk është argument që

mbikëqyrësi i drejtpërdrejt mos të ketë ndikim në mbikëqyrjen e punës së nëpunësit civil, kështu që sipas Kolegjit të Këshillit pretendimi i ankueses është i bazuar.

Sipas rregullativës ligjore në fuqi respektivisht Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me nenin 35 është përcaktuar se: *“Trajnimi gjatë periudhës provuese Gjatë periudhës provuese, nëpunësi civil obligohet të kryejë trajnimin hyrës në shërbimin civil”*, ndërsa sipas kërkesës për përgjigje në ankesë të datës 30.06.2023 është kërkuar *“dëshmi për caktimin e trajnimeve për ankuesen gjatë periudhës”*, kurse përmes përgjigjes në ankesë është dërguar vetëm një Certifikatë për pjesëmarrje në trajnim për periudhën 26 dhe 27 prill 2022 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike me temën *Përgatitja e Raporteve*, si rrjedhojë nuk është ofruar asnjë dëshmi tjetër që ankuesja të ketë kryere trajnimet hyrëse në shërbimin civil, apo nuk është ofruar dëshmi që institucioni t’i ketër dërguar ndonjë plan të trajnimeve, kështu që nuk është plotësuar kushti ligjor nga autoriteti punëdhënës.

Lidhur me ligjshmërinë e vendimeve të kontestuar me këtë ankesë respektivisht Vendimit me numër 08Nr.01-101/03-56473 të datës 16.06.2023 të Udhëheqësit të Drejtpërdrejtë për moskonfirmim të marrëdhënies së punës dhe Vendimit me numër 01 Nr.118/02-30756 të datës 27.06.2023 të Kryetarit të Komunës së Drenasit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankueses, Kolegji i Këshillit, konstaton se nga të lartcekurat rrjedh se nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore për moskonfirmimin e periudhës provuese ndaj ankuese, ngase Komuna e Drenasit me asnjë provë relevante nuk ka mund të argumentoj se janë plotësuar këto kushte duke mos sjell prova konkrete për mos përmbushje të detyrave të punës përgjatë tërë vitit nga ana e ankueses po ashtu nuk ka sjell edhe prova të tjera të cilat do të ishin barrë për mos konfirmim të periudhës provuese, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se këto vendime janë në kundërshtim me dispozita e cekura më lartë të Ligjit Nr./ 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dispozitat e lartcekura të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu si të tilla nuk janë të arsyetuara në pajtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që janë të paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të këtij ligji, kështu që pretendimet e ankueses ndaj këtyre vendimeve janë të bazuara.

Nga të lartcekurat si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se Kryetari i Komunës së Drenasit dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore, janë të obliguar që në pajtim me këtë vendim të kthejnë ankuesen në vendin e punës *Zyrtar për Leje Ndërtimore* sipas Akt Emërimit AE.Nr.01-101/03-56473 të datës 13.01.2022 më të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, duke bërë kompensimin e pagës nga dita e mos konfirmimit të marrëdhënies së punës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.891/2023, datë 31/07/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Drenasit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;